



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI KONKURENCËS

Nr. 632/prot.
/5

Tiranë, më 21.11.2022

VENDIM

Nr. 923 Datë 21.11.2022

“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË RIOFARMA SHPK NGA SHOQËRIA TRIMED SHPK”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21. 11. 2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Riofarma SHPK nga shoqëria Trimed SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Riofarma SHPK nga shoqëria TRIMED SHPK.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Riofarma SHPK nga shoqëria TRIMED SHPK.

Referuar dokumentit “Kontratë për transferim kuotash”, datë 28.09.2022, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: TRIMED SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt veprimtarie; import-eksport tranzit, depo farmaceutike, përfaqësim në fushat farmaceutike, prodhim-përpunim-konfeksion; import-eksport-tranzitim-tregtim me shumicë e pakicë të medikamenteve, materialeve mjekësore e aksesorëve të tyre, barnave, materialeve dentare e veterinare, higjienosanitare, barnave mjekësore popullore, artikujve të ndryshëm kozmetike e produkteve të parukerisë & estetikës, solucioneve injektabel të lëngjeve të distiluara dhe të gazuara, avulli & akulli, produkteve me origjinë bimore e shtazore, etj.; pajisje laboratorike, marketing dhe promocion; import-eksport-tranzitim-tregtim me shumicë dhe pakicë të pajisjeve mjekësore, pajisjeve dhe instrumenteve ortopedike, protezave të artikulacioneve dhe impianteve dentare.

Shoqëria TRIMED SHPK zotërohet nga z. E.H me 50% të kuotave, znj. G.P. me 10% të kuotave dhe z. S.P. me 40% të kuotave.

Shoqëria TRIMED SHPK, gjithashtu, është aksionare me 20% të aksioneve në shoqërinë 3P Life Logistic SHPK, shoqëria që zbaton kontratën e koncesionit “Për kontrollin mjekësor bazë 35-70 vjeç nëpërmjet një seti analizash të miratuara si dhe vizita mjekësore”.

Pala shitëse: E.H. është person fizik, shtetas shqiptar, i cili zotëron 100% të kuotave të Riofarma SHPK.

Shoqëria Target: Riofarma SHPK, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt të veprimtarisë: tregtim me shumicë dhe prodhim i medikamenteve farmaceutike, import-eksport i tyre, pajisje, instrumente medicinale, sanitare, ushqime dietike për fëmijë.

Që nga viti 2010 shoqëria zotërohet nga z. E.H me 100% të kuotave. Kjo shoqëri nuk ka aktivitet ekonomik/tregtar që prej datës 21.02.2011. Përpara kësaj periudhe, target ka qenë aktiv në tregtimin me shumicë të barnave xhenerike.

II. Përqendrimi

Më datë 28.09.2022, është lidhur “Kontratë për transferim kuotash”, ndërmjet shoqërisë blerëse TRIMED SHPK dhe palës shitëse, Z. E.H. Shitësi është ortak i vetëm i shoqërisë Riofarma SHPK dhe zotëron 100% të kapitalit të Riofarma SHPK.

Transaksioni i propozuar konsiston në blerjen e 100% të kapitalit të shoqërisë Riofarma SHPK nga shoqëria TRIMED SHPK, i parashikuar në nenin 10, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Referuar marrëveshjes si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni i propozuar, përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e Konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si edhe objektit të aktivitetit të shoqërive të prekura nga transaksioni, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i shitjes së barnave dhe tregu i shitjes së produkteve medikale. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

– *Tregu i barnave*

Tregu i barnave funksionon në zbatim të ligjit nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”. Për të kryer aktivitet ekonomik, subjektet që operojnë në tregtimin e barnave mjekësore, janë të detyruar të pajisjen me Liçensa profesionale për subjektet farmaceutike (fabrika, importues dhe tregtues me pakicë) për ushtrimin e veprimtarive respektive (fabrikim barnash, tregti me shumicë, farmaci) për barnat narkotike, psikotrope dhe prekursorët e kategorisë 1, e cila lëshohen nga QKB, referuar Ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për Licensat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë“, i ndryshuar.

Shoqëria TRIMED SHPK ushtron aktivitet në tregun e barnave e pajisur me licencë LN-4135-11-2017 dhe LN-3765-09-2011 për “Tregtim me shumicë i barnave për njerëz”; Licenca LN-3450-12-2021 për “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)” dhe Licenca LN-4711-03-2018 për “Shërbime ndërhyrëse higjeno-shëndetësore”, ndërkohë që shoqëria Riofarma SHPK nuk rezulton të ketë Licencë aktive për tregtim të barnave me shumicë.

Referuar të dhënave të administruara gjatë procedurës së hetimit paraprak në tregun e barnave dhe pajisjeve mjekësore, rezulton se shoqëria TRIMED SHPK është një nga ndërmarrjet kryesore në importin e barnave mjekësore duke zotëruar XX % të pjesës së tregut sipas vlerës së importeve të realizuar për vitin 2020 dhe XX% sipas vlerës së rimbursimit të barnave të përfshira në skemën e rimbursimit

Po sipas të dhënave të raportit hetimor, TRIMED SHPK ka deklaruar se tregton XX barna të cilat janë alternative e vetme në treg, por pa ngritur dyshime për ndonjë abuzim të mundshëm me pozitën dominuese në tregtimin e këtyre barnave (analizë e realizuar gjatë procedurave hetimore).

Shoqëria TRIMED SHPK tregton barna OTC (over the counter), të cilat zënë XX% të totalit të barnave që ata kanë tregtuar gjatë vitit 2020, ku përfshihen antiviral, analgjezikë, laksativ, antibacterial, antihistaminik etj.

Shoqëria Riofarma SHPK nuk ka patur aktivitet ekonomik që nga viti 2011.

– *Tregu i produkteve medikale*

Shoqëria TRIMED SHPK është pajisur nga QKB me Licenca LN-4711-03-2018 për “Shërbime ndërhyrëse higjeno-shëndetësore”, me qëllim shitjen e produkteve medikale, të cilat konsistojnë në instrumente dhe pajisje mjekësore, në produkte të kujdesit për lëkurën, markave Algotharm, Ladival, Hei Poa etj.; kujdesit oral të markës Oral-B dhe kujdesit për fëmijët e vegjël nëpërmjet markës Pampers.

Sipas të dhënave të marra nga regjistri i pajisjeve mjekësore pranë Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësorë, konstatohet se shoqëria ka regjistruar për tregtim XX artikuj të cilët konsistojnë kryesisht për trajtimin e procedurave kirurgjikale ortopedike.

Tregu i produkteve medikale, është një treg i gjerë me një shumëllojshmëri të markave dhe produkteve dhe ishte i vështirë evidentimi i madhësisë së tregut dhe shoqërive që veprojnë në këtë treg.

Gjithsesi, shoqëria Riofarma SHPK nuk ka ushtruar aktivitetet dhe nuk ka krijuar të ardhura në këtë treg.

Transaksioni i përfuturit të kontrollit të shoqërisë Riofarma SHPK nga shoqëria TRIMED SHPK, është konsideruar si një përqendrim horizontal meqenëse blerësi dhe targeti operojnë në të njëjtin treg përkatës.

Mbështetur në Udhëzimin “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale”, përcaktohet se ekzistojnë dy mënyra kryesore në të cilat përqendrimet horizontale mund të pengojnë ndjeshëm konkurrencën efektive, përkatësisht, përmes efekteve të pakoordinuara dhe të koordinuara.

- Efektet e pakoordinuara vijnë si rrjedhojë e eliminimit të kufizimeve të rëndësishme të konkurrencës mbi një ose më shumë ndërmarrje, të cilat për pasojë kanë rritur fuqinë e tregut pa përdorur sjellje të koordinuar.

Udhëzimi përcakton se, nëse ekziston një **shkallë e lartë e zëvendësueshmërisë** ndërmjet produkteve të ndërmarrjeve pjesëmarrëse në përqendrim dhe të atyre të ofruara nga prodhuesit rivalë, ka pak mundësi që përqendrimi të kufizojë ndjeshëm konkurrencën efektive, në veçanti nëpërmjet krijimit ose forcimit të një pozicioni dominant,

Përqendrimet horizontale shoqërohen **me eliminimit të një konkurrenti në treg**. Eliminimi i një force të rëndësishme të konkurrencës, ka më shumë ndikim në procesin konkurrues në krahasim me pjesët e tregut që ato zotërojnë apo elementë të tjerë të ngjashëm duke sjellë që një përqendrim ndërmjet ndërmarrjeve të tilla të ndryshojë dinamikën e konkurrencës në mënyrë të ndjeshme anti konkurruese.

Referuar të dhënave të depozituara gjatë procedurës së kontrollit të përqendrimit, por edhe informacionit të administruara gjatë procedurave hetimore, u konstatua se shoqëria Riofarma SHPK nuk ka qenë aktive në treg që nga viti 2011, duke mos e identifikuar atë si një konkurrent aktual dhe eficient. Shoqëria Riofarma SHPK rezulton të jetë prej vitesh një shoqëri me rezultat financiar me humbje.

Për këto arsye, transaksionit të synuar nuk do të ndikojnë konkurrencën në tregun përkatës të produktit nëpërmjet efekteve të pakoordinuara dhe pjesa e tregut e shoqërisë TRIMED SHPK do të mbetet e pandryshuar.

Efektet e koordinuara vijnë si pasojë e ndryshimit të natyrës së konkurrencës në një mënyrë të tillë, që ndërmarrjet që më parë nuk kishin koordinuar sjelljet e tyre, kanë më shumë mundësi që në mënyrë të dallueshme të koordinojnë dhe të ngrenë çmimet apo të dëmtojnë konkurrencën efektive. Gjithashtu, një përqendrim e bën koordinimin më të lehtë, më të qëndrueshëm ose më efektiv për ndërmarrje të cilat koordinonin sjelljen e tyre para përqendrimit.

Lidhur me efektet e koordinuara të përqendrimit, duhet të vlerësohet nëse është e mundur të ketë një koordinim të sjelljes mes ndërmarrjeve pjesëmarrëse, dhe nëse ky koordinim është i qëndrueshëm.

Duke qenë se shoqëria Riofarma SHPK nuk ka aktivitet dhe nuk është një konkurrent aktual në treg, efektet e koordinuara për të ndikuar në konkurrencën në treg, ka shumë pak gjasa të ndodhin në të ardhmen.

Për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Riofarma SHPK nga shoqëria TRIMED SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KOMISIONI I KONKURRENCËS

Leida MATJA

Zv/Kryetar

Rezana KONOMI

Anëtar

Durim KRAJA

Anëtar

